



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL Anr.168/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesues, Afijete Sada-Gllogjani dhe Ymer Hoxha anëtarë, si dhe me pjesëmarrjen e zyrtarit të lartë ligjor Kudret Hasani, duke vendosur përkitazi me ankesën e BIRN dhe INTERNEWS KOSOVA, paraqitur kundër subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR), për shkak të bërjes së fushatës zgjedhore me fëmijë të mitur, për Zgjedhjet Lokale 2017, në seancën e panelit të mbajtur me 12.10.2017, mori këtë:

### V E N D I M

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e BIRN dhe INTERNEWS KOSOVA me të cilën kërkohet që ti shqiptohet dënimi me gjobë ndaj subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR), për shkak të bërjes së fushatës zgjedhore me fëmijë të mitur.

### A r s y e t i m

Me datën 10.10.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga BIRN dhe INTERNEWS KOSOVA me të cilën pretendon se kandidati për kryetar të komunës së Mitrovicës nga subjekti politik AKR Agim Bahtiri ka mbajtur takim në fshatin Pirq, Frashër e Rekë me qytetaret në mesin e tyre ka disa fëmijë dhe se nga fotografia e shpërndarë nga Agim Bahtiri shihet se takimi është mbajtur në objekt shkollor gjatë ditës.

Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur fotografi të printuara lidhur me rastin në fjalë.

Subjekti politik AKR, në përgjigje në ankesë të datës 11.10.2017, e konsideron si të pabazuar ankesën për faktin se takimet janë mbajtur gjatë ditëve të fundjavës kur ambientet shkollorë kanë qenë të lira kur procesi mësimor nuk është mbajtur, ndërsa lidhur me prezencën e dy të rinjëve i njëjti thekson se organizatori me ti vërejtur ka marrë masa duke i larguar nga vendi ku po mbahej takimi, ndërsa fotoja është shktrepur ende pa nisur takimi.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

### **Ankesa është e pabazuar**

Pretendimet ankimore se në aktivitetet e kandidatit për kryetar komune në Mitrovicë nga subjekti politik AKR janë përfshirë fëmijë, Paneli gjeti se këto pretendime janë të paqëndrueshme pasi që nga fotografit që gjenden në shkresat e lëndës nuk mund të identifikohet se janë persona të moshës nën 18 vjet.

Andaj, paneli erdhi në përfundim se janë të paqëndrueshme parashkrimet se është bërë fushatë zgjedhore me fëmijë nga ana e kandidatit të subjektit politik AKR. Me këtë rast paneli konsideron, se parashtruesi i ankesës, me dëshmitë e ofruara nuk i ka vërtetuar pretendimet e tij në mënyrë që paneli të merr vendim në favor të tij.

Nga arsyet e theksuar më e duke bazuar nenin 118 par.1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
ZL. Anr.168/2017 më datën 12.10.2017.



**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.